



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:081023

Datë: 08.07.2020

Numri i dokumentit: 01012764

**P.nr.1012/2019**

**NË EMËR TË POPULLIT**

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtari Alban Ajvazi, në çështjen penale kundër të pandehurit V.G.nga fshati ... Komuna Prishtinë, i akuzuar sipas aktakuzës se Prokurorisë Themelore në Prishtinë PP/II.nr.7697/2018 të datës 15.03.2019, për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.2 të KPRK-së, duke vendosur lidhur me kërkesën e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, për dhënien e urdhrin ndëshkimor, në dt.17.06.2019, mori këtë:

**AKTGJYKIM**

PRANOHET - Kërkesa e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, PP/II.nr.7697/2018 të datës 15.03.2019 dhe kjo gjykatë jep këtë:

**URDHËR NDËSHKIMOR**

I pandehuri: **V.G.**, i biri i Rexhepit, i lindur më ... në Prishtinë, me vendbanim në fshatin ... Komuna Prishtinë, rruga ' S.P.' p.n. , i pa martuar, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës,

**ËSHTË FAJTOR**

**S e p s e:**

Me dt.04.04.2018, rreth orës 21:15, në Prishtinë, pas një mosmarrëveshje paraprake, i akuzuari se bashku edhe me dy persona të tjerë të pa identifikuar deri me tani, me qëllim të shkakimit të lëndimit trupor kanë filluar që të rrihen me tani të dëmtuarit A.K. dhe A.G. dhe duke përdorur mjet të rrezikshëm të pa identifikuar deri më tani, i akuzuari i ka goditur të dëmtuarit në kokë dhe pjesë të ndryshme të trupit, me ç' rast nga goditjet e marra të dëmtuarit kanë lëndime të lehta trupore me pasoja të përkohshme për shëndetin,-

- **Me këtë ka kryer veprën penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.2 të KPRK-së.**

Andaj, gjykata konform nenit të sipërpërmendur dhe neneve 41, 43, 46, të KPRK-së, si dhe neneve 365 e 495, të KPPK-së,:

**E G J Y K O N**

Të akuzuarin V.G.me dënim me gjobë në shumë prej 150.00 (njëqind e pesëdhjetë) €, të cilin dënim është i obliguar që ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse dënimi i shqiptuar në të holla nuk mund të ekzekutohet, gjykata dënimin me gjobë në bazë të nenit 46 par 3 të KPRK-së, do ta zëvendësoj me dënim me burg, ku një ditë burgim do të llogaritet me 20 (njëzet) euro, gjobë.

I njëjti dënimin e shqiptuar mund të paguaj në dy këste. Mundësia e pagesës me këste do të revokohet nëse personi i dënuar nuk e paguan këstin me kohë.

I pandehuri obligohet të paguaj shpenzimet e procedurës penale aq sa do të bëhen sipas llogarisë përfundimtare të kësaj gjykate dhe atë për ekspertizën mjeko-ligjore në shumë totale prej 20.00 (njëzetë) € ndërsa në emër të paushallit gjyqësorë do të paguaj shumën prej 30 (tridhjetë) €, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit me detyrim.

**Të dëmtuarit:** **A.K.** me vendbanim në rrugën ‘ A.Zh.’ Bll. ... Hy-.. nr.... dhe **A.G.** me vendbanim në rrugën ‘ I.K.’ p.n. në Prishtinë, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko-civil.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Prishtinë, me aktakuzën me shenjën, PP/II.nr.7697/2018 të datës 15.03.2019, e ka akuzuar V.G. nga fshati ... Komuna Prishtinë, për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor, nga neni 188 par.2 të KPRK-së, dhe njëherësh, nga gjykata ka kërkuar dhënien e urdhrin ndëshkimor, me arsyetimin se ka prova të besueshme nga kallëzimi penal dhe provat e propozuara lidhur me arsyeshmërinë e aktakuzës së propozuar në drejtim të vërtetimit të fakteve se i pandehuri, vërtetë e ka kryer veprën penale, për të cilën akuzohet.

Gjyqtari i vetëm gjykues, me rastin e shqyrtimit paraprak të çështjes, konform nenit 493, të KPPK-së, gjeti se janë plotësuar kushtet nga neni 495, të KPP-së, dhe pranoi kërkesën për dhënien e urdhrin ndëshkimor si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që në shkresat e lëndës ka prova të mjaftueshme në bazë të të cilave vërtetohet se i pandehuri e ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë.

Kjo gjykatë konsideron se provat e bashkangjitura në shkresat e lëndës, dhe atë: Mendimi dhe konstatimi i ekspertit mjeko-ligjor dr. V.K., i datës 10.03.2019; foto dokumentacioni si dhe shkresat tjera që gjenden në shkresat e lëndës janë prova të besueshme mbi bazën e të cilave vërtetohet se i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor, u mor në bazë të nenit 450 par.2 pika 2.1 dhe 2.6 të KPPK-së.

Në bazë të nenit 463 par. 1 dhe 2 të KPPK-së, pala e dëmtuar është udhëzuar në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore-juridike.

Nga sa u tha më lart, e në bazë të neneve 365 e 495 të KPPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**  
**Departamenti i Përgjithshëm**

**P.nr.1012/ 2019, datë 17.06.2019**

**Gjyqtari  
Alban Ajvazi**

**UDHËZIMI JURIDIK:**

I pandehuri ose mbrojtësi i tij, në afat prej tetë (8) ditëve,  
pas pranimet të këtij aktgjykimi-urdhri ndëshkimorë,  
mund të paraqesin kundërshtim me shkrim ose me gojë.